
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 14.08.2025

PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: Blerje automjesh speciale për DPPSH dhe mjesh transporti për AMP, e ndarë në 2 (dy) lote:

Loti 1: “Blerje automjesh speciale për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

Loti 2: “Blerje mjesh transporti për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Automjete - 34100000-8, Automjete të specializuara - 34114000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 141,099,413.7 (njëqind e dyzet e një milionë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e trembëdhjetë pikë shtatë) lekë pa TVSH, ose 1,452,387.17 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë pikë shtatëmbëdhjetë) Euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 14.08.2025 është 97.15 lekë.

Loti 1: “Blerje automjesh speciale për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit” me fond limit: **103,836,166.7** (njëqind e tre milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) **lekë pa TVSH**, ose 1,068,823.13 (një milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzet e tre pikë trembëdhjetë) Euro pa TVSH

Loti 2: “Blerje mjesh transporti për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore” me fond limit: **37,263,247** (tridhjetë e shtatë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e shtatë) lekë **pa TVSH**, ose 383,564.05 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë zero pesë) Euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1: “BLERJE MINIBUSA PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të

përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40(6) gërma “b” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

5. Operatori Ekonomik pjesëmarres duhet të paraqesë deklaratë garancie në të cilën të jenë të përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike do të fillojë nga data e marrjes në dorezim i mjetit nga autoriteti kontraktor dhe të jetë minimumi:

1- Karrotrec me platformë rrëshqitëse

5 (pesë) vite ose 100,000 km

2- Karrotrec me platformë pirun

5 (pesë) vite ose 100,000 km

3- Pajisje ngritëse teleskopike

5 (pesë) vite ose 2000 orë/pune

Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km+orë pune) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues. Me anë të këtij kriteri kërkohet gjithashtu që ofertuesi të deklarojë frekuencat në km / orë pune të ndërrimit të vajit, si dhe të deklarojë çmimet e këtij të fundit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare,etj).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorëzohen pranë AK të pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2: “BLERJE MJETESH TRANSPORTI PËR AGJENCINË E MBIKËQYRJES POLICORE”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas *Shtojcës 9*;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 4*;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të

operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e autoveturave objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisën e

tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40(6) gërma “b” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC)/ ekuivalent.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qenë se mjetet janë kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE,

detyrimisht është kërkuar paraqitja e certifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu certifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Deklaratë garancie për mjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 3 vjet ose jo më pak se 100,000 km (Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe regjistruara në pronësi të autoritetit kontraktoror përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorëzohen pranë AK të pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**LOTI 1: “BLERJE AUTOMJETESH SPECIALE PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT”**

Nr.	Emertimi	Njësia
1	Karrotrec me platformë rrëshqitëse	copë
2	Karrotrec me platformë pirun	copë
3	Pajisje ngritëse teleskopike	copë

**1. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR KARROTREC ME PLATËFORMË
RRËSHQITËSE**

Të përgjithshme: Kamion tërheqës me platëformë rrëshqitëse,;

Lloji i automjetit:	Kamion tërheqës (Karrotrec)
Modeli i karrocërisë:	Me platforme të rrëshqitëse
Kilometra të përshkruara:	0 km
Viti i prodhimit:	2024-2025

Specifikimet për mjetin;

- | | |
|----------------------------------|-------------------------------------|
| - Karburanti | Naftë; |
| - Emetimi i Gazrave | Min Euro 6; |
| - Kambio | Manuale |
| - Cilindrata | Min. 2900CC - Maks.3100 CC; |
| - Fuqia e motorrit | Min. 105 kW - Max.115 kW; |
| - Sistem A/C Ajer i kondicionuar | Po; |
| - Xhamat | Komandim elektrik; |
| - Sistemi drejtimit | Hidraulik me timon ne krah te majtë |
| - Distanca midis akseve | Min. 3000 mm - Max. 3500 mm; |
| - Numri i akseve | 2 |
| - Konfigurimi i akseve | 4x2; |
| - Nr. i gomave | 7 (përfshirë gomen rezerv) |

- <i>Pesha totale e mjetit me ngarkes</i>	Min. 700 kg – Max. 8500 kg;
- <i>Gjatesia totale e mjetit</i>	Min. 6500 mm
- <i>Gjeresia totale e mjetit</i>	Max. 2,500 mm;
- <i>Numri i dymve të kabinës</i>	2
- <i>Numri i pasagjerëve në kabinë përfshirë shoferin</i>	Minimumi 2
- <i>Sistemi i frenimit</i>	ABS
- <i>Mbyllja qendrore e mjetit</i>	Me pult
- <i>Mbrojtëse anësore</i>	Alumini
- <i>Fenelina</i>	Po
- <i>Ngjyre e mjetit</i>	E bardhe
- <i>Sinjalistika dhe logimi anësore</i>	Fenelina të gjata policie. Në dyert dhe në pjesen para me logon e Policisë së Shtetit

Specifikimet për Platformën;

- <i>Gjatesia e platformes</i>	Min. 5000mm – Max. 6000 mm
- <i>Gjeresia e platformes</i>	Max.2500 mm
- <i>Pesha e ngarkeses</i>	Min. 3500 kg
- <i>Trashësia e dyshemese</i>	Min 4 mm
- <i>Materiali i dyshemese</i>	Anti rreshqitje
- <i>Kontrolli platformes nga ate</i>	Sistem hidraulik, me leva kontrolli

dyja krahët e mjetit në pjesën e pasme të tij.

- <i>Gjatesia e arganelles</i>	Min. 20 m
- <i>Kapaciteti i sistemit të terheqese</i>	Min. 3000 kg

Pajisje ndihmëse;

- Grup rripash veteshtergues
- Ndalesa të rrotave të përparme

Të jetë i kompletuar me:

1. Xhiro Makinë
2. Krik
3. Katalog Teknik i përkthyer në gjuhë shqipe
4. Kuti të ndihmës së shpejtë

2. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR KARROTREC ME PLATËFORMË PIRUN

Të përgjithshme: Kamion tërheqës/ngritës me platëformë pirun;

Lloji i automjetit:	Kamion tërheqës/ngrites (Karrotrec)
Modeli i karrocerisë:	Me platforme pirun dhe sistem tërheqës
Kilometra të përshkruara:	0 km
Viti i prodhimit:	2024-2025
Specifikimet për mjetin;	
- Karburanti	Naftë;
- Emetimi i Gazrave	Min Euro 6;
- Kambio	Manuale ;
- Cilindrata	Min. 5000 CC - Maks.5200 CC;
- Fuqia e motorrit	Min. 150 kW - Max.170 kW;
- Sistem A/C Ajer i kondicionuar	Po;
- Xhamat	Komandim elektrik;
- Sistemi drejtimit	Hidraulik me timon ne krah te majtë
- Distanca midis akseve	Min. 4000 mm - Max. 5000 mm;
- Numri i akseve	2
- Konfigurimi i akseve	4x2;
- Nr. i gomave	7 (perfshire gomen rezerv)
- Pesha totale e mjetit me ngarkes	Min. 18,000 kg – Max. 20,000 kg;
- Gjatesia totale e mjetit	Min. 7500 mm
- Gjeresia totale e mjetit	Max. 2,700 mm;
- Numri i dyerve të kabinës	2
- Numri i pasagjerëve në kabinë perfshire shoferin	Minimumi 2
- Sistemi i frenimit	ABS
- Mbyllja qendrore e mjetit	Me pult
- Mbrojtese anesore	Alumini
- Ngjyrë e mjetit	E bardhe
- Sinjalistika dhe logimi anesore	Fenelina të gjata policie. Në dyert dhe në pjesen para me logon e Policisë së Shtetit
Specifikimet për Platformën;	
- Kapaciteti ngritës	Min 3000 kg
- Platforma ngritëse	Me 2 kulla dhe 4 njesi pirun ngrites
- Funkcionaliteti i platformës	Me sistem levizje te kullës për përshtatjen e dimensioneve të ndryshme midis akseve
- Funkcionaliteti i pistonave të kullës	Me 2 pistonave shtërgues për përshtatjen e dimensionet e ndryshme të gomave
- Materiali i kullës	Çelik, Karbon, Inox
- Kontrolli platformes	Me Joystick brenda dhe jashtë kabinës
- Menyra e ngritjes	Në të dyja krahët e mjetit
- Këmbët stabilizuese	4 copë për stabilitet maksimal
- Funksonimi i sistemit ngrites	Nëpërmjet fuqisë së PTO
- Sensorët PTO	Visual dhe akustik

- Ekrani monitorues brenda kabinës	Min 9" LCD
- Koha e operimit	15 cm/sek sipas çertifikimit 2006/42/EC
- Numri i kamerave	Min. 4 kamera HD
- Sensor stabiliteti	Po
- Sensor për lëvizjen horizontale	Po
- Platforma tërheqëse	Me peshe ngritëse jo më pak se 1500 kg

Pajisje ndihmëse;

- Grup rripash veteshtergues
- Ndalesa te rrotave te perparme

Të jetë i kompletuar me:

1. Xhiro Makinë
2. Krik
3. Katalog Teknik i perkthyer ne gjuhe shqipe
4. Kuti të ndihmës së shpejtë

3. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR PAJISJE NGRITËSE TELESKOPIKE

Të përgjithshme: Ngritës Teleskopik;

Lloji i mjetit:	Pirun ngrites
Ore pune të përshkruara:	0 ore (0 km)
Viti i prodhimit:	2024-2025

Motorri

- Fuqia	Min. 70 kW – Max.86 KW
- Numri i cilindrave	Min.4
- Cilindrata	Min. 3500 CC – Max. 3800 CC
- Emisioni i gazrave	Min. Stage V
- Lënda Djegëse	Naftë

Sistemi hidraulik

- Presioni	Min. 240 bar
- Prurja e pompes hidraulike	Min. 130 litra/min
- Transmisioni	Hidrostatik me dy shpejtesi

Dimensionet dhe karakteristikat e përgjithshme

➤ <i>Lartësia e kabines së mjetit</i>	Min. 2700 – Max 2900 mm
➤ <i>Gjerësia e mjetit</i>	Min. 2200 - Max. 2400 mm
➤ <i>Gjatesia e mjetit pa thikat</i>	Min. 6000 - Max. 6300 mm
➤ <i>Lartësia e ngritjes në pikën maksimale</i>	Min. 15 m
➤ <i>Pesha e ngritjes në pikën maksimale</i>	Min. 2500 kg
➤ <i>Distance aksiale</i>	Min. 3000 – Max 3200 mm

Pesha e mjetit

➤ <i>Pesha</i>	Min. 11000 - Max. 13000 kg
➤ <i>Pesha e ngarkesës maks</i>	Min. 4000 – Max 4500 kg

Mjeti duhet të jetë i pajisur:

1. Sistem kundër rreshkitjes
2. Certifikatë konformiteti CE
3. Kontrolli i mjetit me Joystick
4. Sistem kondicionimi AC
5. Mbrojtës xhami përpara
6. Thika pirun
7. Këmbë stabilizues për mjetin

Të jetë i kompletuar me:

1. Xhiro Makinë
2. Krik
3. Gomë rezervë
4. Katalog Teknik i përkthyer në gjuhë shqipe
5. Kuti të ndihmës së shpejtë

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga strukturat e posaçme pranë autoritetit kontraktor përfitues, në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

LOTI 2: “BLERJE MJETESH TRANSPORTI PËR AGJENCINË E MBIKËQYRJES POLICORE”

Nr.	Emertimi	Njesia
1	Autovetura SEDAN me 4+1 vende	cope
2	Autovetura SUV	cope

Kërkesa të përgjithshme

1. Të ofrohet mjet rrugor i kërkuar sipas përshkrimeve në këto dokumente tenderi për lotin 2.
2. Mjetet të jenë të pajisura me dokumentacionin e duhur sipas legjislacionit shqiptar, të targuara, leje qarkullimi, sigurimin e detyrueshëm TPL.
3. Mjeti të jetë i pajisur me katalogun e mjetit, çertifikatën e konformitetit, të përkthyer në shqip.
4. Mjetet rrugore të kenë garanci jo më pak se 3 vjet ose 100.000 km (Cilado që plotësohet e para). (Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë).
5. Mjetet duhet të jenë të reja dhe të pa përdorura.
6. Mjeti të jetë prodhim i dy viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
7. Afati i lëvrimit: Të bëhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

1. SPECIFIKIMET TEKNIKE PER BLERJE AUTOVETURE ME 4+1 VENDE

Lloji: Autoveturës “SEDAN”

Motori:**Min 1.5 litra**

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Lënda djegëse | Naftë |
| 2. Fuqia motorike | Min 84Kw/115 Kf |
| 3. Cilindrata | Min 1450 cm ³ |
| 4. Nr.i cilindrave | Min 4 |
| 5. Konsumi i karburantit të kombinuar: | Max. 5.5 litra për 100 km. |

Transmisioni:

- | | |
|--------------------------------|-----------------|
| 1. Kutia e shpejtësisë (Kamio) | Automatike |
| 2. Shpejtësia maksimale mjetit | Min 180 km/orë. |
| 3. Tërheqja | 4x2. |

Përmasat e autoveturës:

- | | |
|---------------------|--------------|
| 1. Gjatësia | Min 4600 mm. |
| 2. Gjerësia | Min 1800 mm. |
| 3. Lartësia | Min 1400 mm. |
| 4. Distanca aksiale | Min 2600 mm. |

Gabina:

- | | |
|------------------|---------|
| -Numri i dymve | 4+1 |
| -Numri i vendeve | Min 4+1 |

Masa (pesha) e mjetit:

1. Masa e mjetit bosh (kg), min: 1300.

Sistemi i drejtimit:

1. Elektrik/hidraulik
2. Timon i rregullueshëm në krahun e majtë

Ngjyra :

E Zezë, Blu e errët.

Klasifikimi mjedisor:

1. Klasifikimi mjedisor: min euro 6,
2. Normat e emëtimit të CO₂: të jenë brenda normave të BE-së.

Aksesorë shtesë:

- Ajër i kondicionuar/clima,
- Min Radio MP3/ USB, me ekran me prekje min 7"

- Pasqyrat e jashtme me rregullim elektrik,
- Funkcioni start/stop, për motorrin,
- Rregullator automatik të shpejtësisë
- Sinjalizues për dalje nga korsia
- Sistemi frenimit ABS, ESP, ESC
- Xhamat e dyerve me komandim elektrik,
- Xhami i mbrapëm me ngrohje,
- Sinjalizues për presionin e gomave,
- Gomë rezerve normale.
- Airbag para & anësor min 6 airbag,
- Rregjistrim lartësie për timonin,
- Komplet i veglave të drejtuesit të mjetit,
- Sistemi elektrik 12V, si dhe të jetë konform normave të BE
- Mbyllja e centralizuar e dyerve, komandim në distancë.
- Sensor parkimi(min mbrapa)

2. SPECIFIKIMET TEKNIKE PER BLERJE AUTOVETURE FUORISTRADË (SUV)

Lloji : Autoveturës “SUV”

Motori:

Min 1.6 litra

- | | |
|--|--------------------------|
| 1. Lënda djegëse | Naftë |
| 2. Fuqia motorike | Min 100 Kw/136 Kf |
| 3. Cilindrata | Min 1598 cm ³ |
| 4. Nr.i cilindrave | Min 4 |
| 5. Konsumi i karburantit të kombinuar: | Max. 7 litra për 100 km. |

Transmisioni:

- | | |
|--------------------------------|-----------------|
| 1. Kutia e shpejtësisë (Kamio) | Automatik |
| 2. Shpejtësia maksimale mjetit | Min 180 km/orë. |
| 3. Tërheqja | 4x2. |

Përmasat e autoveturës:

- | | |
|----------------------|--------------|
| 1. Gjatësia | Min 4300 mm |
| 2. Gjerësia | Min 1800 mm. |
| 3. Lartësia | Min 1600 mm. |
| 4. Distanca aksiale | Min 2600 mm. |
| 5. Lartësia nga toka | Min 160 mm |

Gabina:

-Numri i dyerve	4+1
-Numri i vendeve	Min 4+1

Masa (pesha) e mjetit:

1. Masa max e autorizuar (kg), max: 2500,

Sistemi i drejtimit:

1. Elektrik/hidraulik
2. Timon i rregullueshëm në krahun e majtë

Ngjyra :

E Zezë, Blu e errët.

Klasifikimi mjedisor:

1. Klasifikimi mjedisor: min euro 6,
2. Normat e emetimit të CO₂ , të jenë brenda normave të BE-së

Aksesorë shtesë:

- Ajër i kondicionuar/clima,
- Min Radio MP3/ USB, me ekran me prekje min 8"
- Pasqyrat e jashtme me rregullim elektrik,
- Funkcioni start/stop, për motorrin,
- Rregullator automatik të shpejtësisë
- Sinjalizues për dalje nga korsia
- Sistemi frenimit ABS, ESP, ESC
- Xhamat e dyerve me komandim elektrik,
- Xhami i mbrapëm me ngrohje,
- Sinjalizues për presionin e gomave,
- Gomë rezerve normale.
- Airbag para & anësor min 6 airbag,
- Rregjistrim lartësie për timonin,
- Komplet i veglave të drejtuesit të mjetit,
- Sistemi elektrik 12V, si dhe të jetë konform normave të BE
- Mbyllja e centralizuar e dyerve, komandim në distancë.
- Sensor parkimi(min mbrapa)

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga strukturat e posaçme pranë autoritetit kontraktor përfitues, në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT